



UNMIK

MEM

MINISTRIA E ENERGISË DHE MINIERAVE  
MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA  
MINISTRY OF ENERGY AND MINING



---

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS

VLADA KOSOVA

GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E ENERGISË  
DHE MINIERAVE

MINISTARSTVO ENERGIJE  
I RUDARSTVA

MINISTRY OF ENERGY  
AND MINING

---

# **PLANI PËR IMPLEMENTIMIN E ACQUIS MBI BURIMET RIPËRTËRITËSE**

**(Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

Prishtinë, Shkurt 2007

## Hyrje

Në kornizën e Traktatit të Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore, nga secila pale kontraktuese kërkohet, përfshirë këtu edhe Kosovën, që brenda një viti nga hyrja në fuqi e Traktatit, të zhvillojnë planin për implementimin e *acquis* mbi burimet ripërtëritëse.

Fokusimi dhe përqëndrimi i Traktatit është në planifikimin e implementimit në aspektin afatmesëm të:

- A. Direktivës 2001/77/EC të Këshillit të Parlamentit Evropian të datës 27 Shtator mbi promovimin e energjisë elektrike prodhuar nga resurset ripërtëritëse të energjisë në tregun e brendshëm të energjisë elektrike, dhe të,
- B. Direktivës 2003/30/EC të Këshillit të Parlamentit Evropian të datës 8 Maj 2003 mbi promovimin e përdorimit të bio karburanteve ose karburanteve tjera ripërtëritëse për transport

Në fillim të muajit Shkurt 2007, Sekretariati i Traktatit në Vjen ka zhvilluar një shabllon dhe iu është shpërndarë palëve kontraktuese një plan i tillë. Ky shabllon është përdorur për zhvillimin e Planit Kosovar për Implementimin e dy Direktivave të Parlamentit Evropian të lartë përmendura.

Plani është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë dhe konsultim me përfaqësuesit e institucioneve vijuese:

1. Ministrisë së Energjisë dhe Minierave
2. Zyrës së Rregullatorit të Energjisë
3. KOSTT-it JSC (Sistemit të Transmetimit të Energjisë dhe Operatorit të Tregut)
4. Znj. Lejla Uzicanin, Shtylla e IV, UNMIK

Gjithashtu, kontribut i vlefshëm është siguruar edhe nga ana e Znj. Lendita Gashi, Ushtrueses së Detyrës në Sektorin e Energjisë pran Agjencisë Evropian për Rindërtim (AER).

Ky Plan është zhvilluar me ndihmën e Konsortiumit Eptisa Internacional. Gjithashtu, kjo shkon në përgjigje të detyrës 6.3 siç kërkohet në Projektin e AER-it „Vazhdim i përkrahjes institucionale Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Kosovë”.

Plani Kosovar për Implementimin e *Acquis* mbi burimet Ripërtëritëse pason.

**A. Plani Kosovar për Implementimin e Direktivës 2001/77/EC të Këshillit Parlamentar Evropian të datës 27 Shtator 2001, mbi promovimin e energjisë elektrike prodhuar nga burimet ripërtëritëse të energjisë në tregun e brendshëm të energjisë elektrike**

I	II	III	IV	V
Nr.	VEPRIMI	AUTORITETI PËRGJEGJËS	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
1.	<b>Caqet Indikative Kombëtare (Neni. 3)</b>			
a	Raporti mbi vendosjen e caqeve indikative kombëtare për konsumimin e ardhshëm të energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet Ripërtëritëse të Energjisë në aspektin e përqindjes së konsumimit të energjisë elektrike për 10 vitet e ardhshme (Neni. 3.2)	Palët Kontraktuese	Jo më vonën se data 1 Korrik 2008, dhe çdo 5 vite pas kësaj	Gjithashtu skico masat e marra ose të planifikuara, në nivel kombëtarë, për arritjen e këtyre caqeve kombëtare indikative; Për vendosjen e caqeve, duhet të merret parasysh vlerat referuese që në një mënyrë të jenë të pajtueshme me Shtojcën; Siguro pajtueshmëri të caqeve me çfarëdo përkushtimi kombëtarë referuar në Protokollin e Kyoto-së UNFCCC;
		MEM-i dhe ZRrE	Dhjetor 2007	<p>1. Kosova nuk është pjesë e Kyoto Protokollit, andaj nuk ka caqe në atë kornizë pune.</p> <p>2. Ligji Kosovar i Energjisë mbështet zhvillimin e një Programi të Efiçencës së Energjisë dhe Energjisë Ripërtëritëse, dhe themelimin e caqeve indikative për shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse.</p> <p>3. MEM-i, në bashkëpunim të ngushtë me ZRrE, dhe me partnerët tjerë kyç, ka përgatitur Programin e Efiçencës së Energjisë dhe Energjisë Ripërtëritëse për periudhën 2007-2009.</p> <p>4. Ministria e Energjisë dhe Minerave (MEM-i) ka hartuar caqet indikative vjetore për shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse për periudhën 10 vjeçare 2007-2016. Këto caqe të propozuara janë dizajnuar dhe bazuar në studimin e para-fizibilitetit të orkestruar gjatë vitit 2006, për potencialet të hidrocentraleve të vogla në Kosovë, dhe parashikim të kërkesës së energjisë dhe bilanceve të furnizimit për të njëjtët periudhë.</p>

**Plani Kosovar për Implementimin e Acquis mbi burimet Ripërtëritëse (Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

I	II		III	IV	V
Nr.	VEPRIMI		AUTORITETI PËRGJEGJËS	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
					<p>5. Masat kyçe të propozuara përfshijnë: (i) krijimin e ngasjes së tregut (gjithnjë mjaft të lartë) tarifat inkorporuese për energjinë elektrike prodhuar nga burimet ripërtëritëse, (ii) prioritet për hapjen e qasjes së rrjetit energjetik për energji të tillë, dhe (iii) hapja e konkurrencës për zhvilluesit privat të burimeve ripërtëritëse. MEM-i ka përgatitur Termet Referuese dhe është duke shikuar për financim për studim për qasje në potencialet e burimeve ripërtëritëse, përveç potencialeve të vogla hidroenergjetike.</p> <p>6. MEM-i do të sigurojë implementimin e lartë përmendur, në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.</p> <p>7. Deri në Dhjetor 2007, MEM-i do të raportojë Sekretariatit të TKE mbi vendosjen e caqet indikative kombëtare për furnizimin e ardhshëm e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet Ripërtëritëse të Energjisë në aspektet e përqindjes të konsumimit të energjisë elektrike për 10 vitet e ardhshme.</p>
b	Raporti mbi një analizë të suksesit në plotësimin e caqeve indikative kombëtare, dhe cilët indikativë dhe në çfarë shkalle masat e marra janë konsekuente me angazhimet kombëtare të ndryshimit klimatik (Neni. 3.3)		Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2009, dhe pas kësaj çdo 2 vite	Merr parasysh, në veçanti faktorët klimatik që mund të afektojnë arritjet e caqeve; Gjithashtu Palët Kontraktuese ose organet kompetente, këtu, do të skicojnë masat e marra për të siguruar siguri të sistemit garantues (Neni. 5.5);
			MEM-i	Mars 2009	<p>1. Progresi që raporton mekanizmat mbi arritjen e caqeve indikative janë identifikuar, dhe janë përfshirë në Programin e Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve Ripërtëritëse të Energjisë për periudhën 2007 – 2009.</p> <p>2. Aktualisht, Kosova nuk ka ndonjë përkushtim kombëtarë për ndryshimin klimatik të ndryshimit kombëtarë. Synohet që të ndërmerret një studim imediat për inventar të emetimeve të gazrave të serrave pasi që Kosova do të ketë lejueshmëri dhe aplikojë për pjesëmarrje në protokollin e Kyoto-s.</p>

**Plani Kosovar për Implementimin e Acquis mbi burimet Ripërtëritëse (Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

I	II		III	IV	V
Nr.	VEPRIMI		AUTORITETI PËRGJEGJËS	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
					1. Raporti i Progresit do të përfshijë përshkrimin mbi të gjitha mekanizmat e paraqitura për të siguruar saktësi dhe garanci të origjinës, dhe përshkrimin e përvojës praktike të bërë.
	c	Raporti mbi konkluzionet e vlerësimit se në çfarë shkalle (Art. 3.4): <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Palët Kontraktuese kanë bërë progres drejt arritjes së caqeve të tyre; dhe</li> <li>▪ Caqet kombëtare indikative janë konsekuent me caqet indikative globale.</li> </ul>	Komisioni Evropian	Jo më vonë se data 1 Korrik 2010, dhe pas kësaj çdo dy 2 vite	Ky raport do të bazohet në raportet e Palës Kontraktuese 1.a dhe 1.b;  Caqet Indikative globale: 12% të konsumimit të energjisë kombëtare bruto deri më 2010 dhe 22.1% të pjesës indikative të energjisë elektrike prodhuar nga Burimet e Ripërtëritëse të Energjisë në totalin e konsumimit të energjisë elektrike të Komunitetit deri në vitin 2010;
2.	<b>Skemat Mbështetëse (Neni. 4)</b>				
	a	Aplikimi i mekanizmave sipas së cilës prodhuesi i energjisë elektrike, në bazë të rregullave të lëshuar nga autoriteti publik, pranon ndihmë direkte dhe jo direkte dhe cilat mund të kenë efekt të kufizimit të tregtisë (Neni. 4.1)	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2009	Lista dhe përshkrimi i mekanizmave;
			MEM-i dhe ZRrE	Prill 2009	Mekanizmat kyçe të propozuara përfshijnë: (i) krijimin e tregut të tarifave inkomporuese për energji elektrike prodhuar nga burimet ripërtëritëse, përfshirë tarifën inkomporuese për sigurim minimal që mbulojnë kostot e prodhimit të energjisë elektrike, (ii) prioriteti i hapjes për qasje në rrjetin e energjisë elektrike prodhuar nga burimet ripërtëritëse (iii) kontratat afat gjate merr-apo paguaj (iv) hapja e konkurrencës për zhvilluesit privat të burimeve ripërtëritëse të energjisë

**Plani Kosovar për Implementimin e Acquis mbi burimet Ripërtëritëse (Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

I	II		III	IV	V
Nr.	VEPRIMI		AUTORITETI PËRGJEGJËS	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
	b	Raporti mbi përvojën e përfituar me aplikimin dhe koekzistimin e mekanizmave të ndryshëm nën 2.a (Neni. 4.2)	Komisioni Evropian	Jo më vonë se 1 Korrik 2011	<p>Vlerësimi i aplikimit të mekanizmave që përdoren në Palët Kontraktuese nën 2.a (Neni. 4.1);</p> <p>Ky raport do të vlerësojë suksesin, përfshirë kost-efektivitetin, të sistemeve mbështetëse në promovimin e konsumimit të energjisë elektrike prodhuar nga Burimet Ripërtëritëse të Energjisë në pajtim me caqet indikative kombëtare;</p> <p>Raporti do të, nëse është e domosdoshme, do të shoqërohet nga korniza e punës me qëllim të mbështetjes së skemave për energjinë elektrike prodhuar nga Burimet Ripërtëritëse të Energjisë;</p>
3.	<b>Guarantee of origin of electricity produced from RES (Art. 5)</b>				
	a	Emërtimi i një apo më shumë organi kompetent, aktiviteteve të pavarura të gjenerimit dhe distribuimit, mbikëqyrja e çështjes së garantimit të origjinës (Neni. 5.2)	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2009	<p>Siguro që origjina e energjisë elektrike e prodhuar nga Burimet e Energjisë Ripërtëritëse mund të garantohet si e tillë, sipas kriterit të përcaktuar nga secila Palë Kontraktuese (Neni. 5.1);</p> <p>Garancitë e origjinës duhet që të njihen në mënyrë të ndërsjellët nga Palët Kontraktuese, posaçërisht si vërtetim të elementeve vijuese (Neni. 5.4):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Garancitë e origjinës do të ( Neni 5.3) specifikojë burimin e energjisë prej së cilës energjia elektrike është prodhuar, specifikuar datat dhe vendet e prodhimit dhe në rast të instalimeve hidroelektrike, trego kapacitetin, dhe</li> <li>▪ Garancitë e origjinës do të ( Neni. 5.3) shërbejë si mundësi për prodhuesit e energjisë elektrike nga Burimet Ripërtëritëse të Energjisë të demonstrojnë që energjinë elektrike që ata shesin është prodhuar nga BRE;</li> </ul>
			ZrRE	Prill 2009	<p>1. ZrRE do të merret me çështjen e „certifikatës së gjelbër” që garanton origjinën e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE</p> <p>2. Garancitë e origjinës do të jetë të ndërsjellët me ata të</p>

**Plani Kosovar për Implementimin e Acquis mbi burimet Ripërtëritëse (Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

I	II		III	IV	V
Nr.	VEPRIMI		AUTORITETI PËRGJEGJËS	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
					Palëve Tjera Kontraktuese të TKE
4.	<b>Procedurat Administrative (Neni. 6)</b>				
	a	Vlerësimi i legjislacionit ekzistuese dhe kornizës së punës rregullative me qëllim të proceduarve të autorizuar (Neni. 6.1)	Palët Kontraktuese ose organet kompetente nga palët kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2009	Vlerësimi do të bëhet me pikëpamje të: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Reduktimit të barrierave të rregullatorit dhe jo-rregullatorit;</li> <li>▪ Efektshmërisë dhe proceduarve për shpenzim; dhe</li> <li>▪ Siguruar që rregullat janë objektive, transparente, jo-diskriminuese, dhe të merren plotësisht parasysh në veçanti llojet e ndryshme të teknologjisë së BRE;</li> </ul>
			MEM-i dhe ERO	Prill 2009	Vlerësimi do të synojë në: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Reduktimin e barrierave të zhvillimit të BRE;</li> <li>▪ Efektshmëri dhe proceduar për shpenzim; dhe</li> <li>▪ Siguruar që rregullat janë objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe të merren plotësisht parasysh në veçanti llojet e ndryshme të teknologjisë së BRE</li> </ul>
	b	Raporti mbi vlerësimin e legjislacionit ekzistues dhe kornizës së punës rregullative (nën 4.a) tregon veprimet e marra adekuate (Neni. 6.2)	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se 1 Korrik 2009	Qëllimi i këtij raporti (Neni. 6.2) është sigurimi dhe ndikimi i fazës së arritur, në mënyrë specifike a) koordinimin në mes të organeve të ndryshme administrative për sa i përket afateve të fundit, perceptimit, dhe trajtimit të aplikacioneve për autorizim; b) hartimin e mundur të direktivave për aktivitete dhe fizibilitetin e proceduarve të planifikimit të ndjekjes së-shpejt për prodhuesit e energjisë elektrike nga BRE; c) emërtimin e autoriteteve që të veprojnë si ndërmjetësues në diskutim në mes të autoriteteve përgjegjëse për lëshimin e autorizimeve dhe aplikuesve për autorizim; <p>Në këtë raport mbi vlerësimin e legjislacionit ekzistues dhe kornizës së punës të rregullatorit (nën 4.b), të konsiderohen gjithashtu masat të cilat duhet të merren për lehtësimin e qasjes në sistemin rrjetit të energjisë elektrike nga BRE (Neni.</p>

**Plani Kosovar për Implementimin e Acquis mbi burimet Ripërtëritëse (Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

I	II	III	IV	V
Nr.	VEPRIMI	AUTORITETI PËRGJEGJËS	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
				7.7)
		MEM-i dhe ZRrE	Prill 2009	Raporti do të vlerësojë kornizën e punës rregullative ekzistuese dhe propozimin e veprimeve të duhura që do të ndermirën
5.	<b>Grid system issues (Art. 7)</b>			
a	Merr masa të domosdoshme për tu siguruar që Operatorët e Sistemeve Transmetuese dhe Operatorët e Sistemeve Distribuuese në territorin e tyre të garantojnë që transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike është prodhuar nga BRE (Neni. 7.1)	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2009	Pa paragjykim ndaj mirëmbajtjes së besueshmërisë dhe sigurisë së rrjetit; Dispozitë për prioritet të qasjes në sistemin e rrjetit të energjisë elektrike prodhuar nga BRE; Kurrë shpërndahen instalimet gjeneruese, OST-të do ti japin prioritet instalimeve gjeneruese përdorur BRE përderisa operimi i sistemit kombëtarë i energjisë elektrike lejon;
		MEM-i, ZRrE, KOSTT dhe KEK JSC	Mars 2009	MEM-i dhe ZRrE do të sigurojnë që masat e domosdoshme janë marr që të sigurohet se KOSTT dhe KEK JSC në territorin e tyre garantojnë transmetim dhe distribuim të energjisë elektrike prodhuar nga BRE  KOSTT dhe KEK JSC do të zhvillojnë dispozita prioritare të qasjes për kyçe dhe nisje të energjisë elektrike prodhuar nga BRE  Siç theksohet në Nenin 11 të Ligjit mbi Energjinë (Nr. 2004/8) dhe Neni 9.2.2.2 të Kodit Planifikues (Kodit të Rrjetit):  Kur shpërndahet gjenerimi, KOSTT-i do të jap prioritet gjenerimit nga burimet ripërtëritëse të energjisë siç lejohet nën rregullat dhe procedurat tjera aplikative.  KOSTT-i do të përgatis Planin Kompetent Gjenerues, i cili do të përfshijë përgjatë tjerëve zgjedhjen e burimit primar me mundësi të vëmendjes së BRE dhe kushteve mjedisore.



**Plani Kosovar për Implementimin e *Acquis* mbi burimet Ripërtëritëse (Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

I	II	III	IV	V	
Nr.	VEPRIMI	AUTORITETI PËRGJEGJËS	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT	
	b	Vendosë kornizën ligjore apo të kërkohet nga OST-të dhe OSD-të ti vendosin dhe publikojnë rregullat e tyre standarde lidhur me aspektet e kostove të adaptimeve teknike, siç është lidhjet në rrjet dhe përforcimet e rrjetit (Neni. 7.2)	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2009	<p>Adaptimet teknike, lidhjet e rrjetit dhe përforcimet e rrjetit, të cilat janë të domosdoshme në mënyrë që të integrohen prodhuesit e ri që furnizojnë energji elektrike prodhuar nga BRE nga në atë të rrjetit ndërlidhës;</p> <p>Këto rregulla do të bazohen në kriterin që merr parasysh të gjitha kostot dhe beneficionet shoqëruar me lidhjen e këtyre prodhuesve në rrjet ;</p> <p>Këto rregulla mund të sigurojnë për lloje të ndryshme të lidhjes;</p> <p>Kurrë e përshtatshme, nga OST-të dhe OSD-të mund të kërkohet që të sigurojnë, pjesërisht apo plotësisht , kostot e referuara në Nenin 7.2 (Neni. 7.3);</p> <p>Kërko nga OST-të dhe OSD-të të sigurojnë prodhues të ri të cilët dëshirojnë të lidhen me gjithëpërfshirje dhe llogaritje të detajuar të kostove shoqëruara me lidhje (Neni. 7.4)</p>
			MEM-i, ZRrE KOSTT dhe KEK JSC	Mars 2009	<p>MEM-i dhe ZRrE do të sigurohen që korniza ligjore të kërkojë nga KOSTT dhe KEK JSC të vendosin dhe publikojnë rregullat e lidhur me sigurimin e kostove të adoptimeve teknike, siç është lidhjet e rrjetit dhe përforcimet e rrjetit</p> <p>KOSTT dhe KEK JSC do të vendosin dhe publikojnë rregullat e tyre standarde lidhur me sigurimin e kostos së adaptimeve teknike, përfshirë lidhjet e rrjetit dhe përforcimet e rrjetit</p> <p>Është propozuar që prodhuesit e energjisë elektrike të ndërtojnë linjën lidhëse në pikën lidhëse më të afërt të mundur të rrjetit të energjisë elektrike ekzistues</p>
	c	Vendosë kornizën legale apo të kërkohet nga OST-të dhe OSD-të të vendosin dhe publikojnë rregullat e tyre standarde për ndarjen e kostove të sistemit instalues, siç është lidhjet e rrjetit dhe përforcimet në rrjet, në mes të të gjithë prodhuesve që përfitojnë nga ata (Neni. 7.5)	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2009	Ndarja do të detyrohet nga mekanizimi bazuar në kriterin, marr parasysh përfitimet të cilët fillimisht dhe më pas prodhuesit të cilët janë të lidhur, si dhe OST-të dhe OSD-të përfitojnë nga lidhjet;
		ZRrE dhe MEM-i	Mars 2009	ZRrE dhe MEM-i do të koeperojnë për të vendosur kornizën e	

**Plani Kosovar për Implementimin e *Acquis* mbi burimet Ripërtëritëse (Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

I	II	III	IV	V
Nr.	VEPRIMI	AUTORITETI PËRGJEGJËS	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
				punës e cila do të kërkojë nga KOSTT-i dhe KEK-u të vendosin dhe publikojnë rregullat e tyre standarde lidhur me ndarjen e kostos së sistemit instaluese, siç janë lidhjet e rrjetit dhe përforcimet e rrjetit në mes të gjithë prodhuesve që përfitojnë nga ata
	d Siguro që ratat/tarifat e ngarkuara të transmetimit dhe distribuimit nuk diskriminohet kundrejt energjisë elektrike nga BRE (Neni. 7.6)	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2009	Përfshirë në veçanti energjinë elektrike të prodhuar nga BRE në regjionet periferike, siç është regjionet ishull dhe regjionet me popullatë të vogël;  Kurrë është e mundur, vendos kornizën ligjore ose kërko nga OST-të dhe OSD-të të sigurojnë që ratat/tarifat e ngarkuara për transmetim dhe distribuim të energjisë elektrike nga impiantet që përdorin BRE reflektojnë përfitimet të kostos së realizueshme, rezultat nga lidhjet e impianteve në rrjet (Neni. 7.6)
		ZRrE	Dhjetor 2008	ZRrE do të sigurojë që ngarkimi i tarifave/ratave të transmetimit dhe distribuimit nuk diskriminohet kundrejt energjisë elektrike nga BRE
6.	<b>Raporti përmbledhës (Neni. 8)</b>			
	a Raport përmbledhës mbi implementimin e Direktivës (Neni. 8)	Komisioni Evropian	Jo më vonë se data 1 Korrik 2011, dhe pas kësaj çdo 5 vite	Në bazë të raportit mbi analizën e suksesit (nën 1.b) dhe raportit mbi legjislacionin ekzistues dhe kornizës së punës së rregullatorit (nën 4.b);  Pas konsultimit me Palët Kontraktuese, Këshilli Evropian në këtë raport do të konsiderojë formën dhe metodat që Palët Kontraktuese mund ti ndjekin, në mënyrë që të garantojnë origjinën e energjisë elektrike prodhuar nga BRE (Neni. 5.6);  Këshilli Evropian në këtë raport dhe në bazë të raporteve të Palëve Kontraktuese mbi vlerësimin (nën 4.b) gjithashtu vlerëson praktikën më të mira me pikëpamje të arritjes së objektivave referuar në Nenin 6.1 (Neni. 6.3);  Nëse e duhur, Komisioni do të dorëzojë së bashku me raportin përmbledhës propozime të mëtejshme;

**B. Plani Kosovar për Implementimin e Direktivës 2003/30/EC të Këshillit të Parlamentit Evropian të datës 8 Maj 2003 mbi promovimin e përdorimit të bio karburanteve ose karburanteve tjera ripërtëritëse për transport**

I	II	III	IV	V
Nr	VEPRIMI	AUTORITETET PËRGJEGJËSE	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
1.	<b>Caqet Indikative Kombëtare (Neni. 3)</b>			
a	Vendosë Caqet Indikative Kombëtare dhe siguro që proporcioni minimal i bio karburanteve dhe karburantet tjera ripërtëritëse janë plasuar në treg (Neni 1.a)	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2008	Vlerë referuese për këto caqe do të jetë 2%, kalkuluar në bazë të përmbajtjes së energjisë, për të gjitha benzinat dhe disel për qëllime të transportit plasuar në treg deri më 31 Dhjetor 2005 (Neni. 3.1. b.i); Vlerë referuese për këto caqe do të jetë 5.75%, kalkuluar në bazë të përmbajtjes së energjisë plasuar në treg deri më 31 Dhjetor 2010 (Art. 3.1. b.ii);
		MEM-i	Dhjetor 2007	1. Ligji mbi Energjinë caktuar për MEM-in detyra për zhvillimi e legjislacionit sekondar të burimeve ripërtëritëse të energjisë mbi promovimin e 2. MEM-i ka përgatitur draft udhëzimin administrativ mbi përdorimin e bio karburanteve në transport deri në Dhjetor 2015
b	Monitoro efektin e përdorimit të bio karburanteve në përzierjet e diselit mbi 5% të automjeteve jo-adoptile (Neni. 3.3)	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2008	Kurrë është e mundur, merr masa për të siguruar përputhshmëri me legjislacionin e Komunitetit relevant (Evropian) mbi standardet e emetimit (Neni. 3.3); Në matje, konsidero klimën e përgjithshme dhe bilancin mjedisor të llojeve të ndryshme të bio karburanteve dhe karburanteve tjera ripërtëritëse (Neni. 3.4);
		MEM-i dhe MMPH	Qershor 2008	1. Informata mbi efektet mjedisore të bio karburanteve në përzierjet e diselit mbi 5% do të ndahet me vendet tjera të BE-së për të zhvilluar, nëse e domosdoshme, masat për pajtueshmëri me standardet e emetimit në Kosovë.

**Plani Kosovar për Implementimin e Acquis mbi burimet Ripërtëritëse (Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

I	II		III	IV	V
Nr	VEPRIMI		AUTORITETET PËRGJEGJËSE	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
					<p>2. Shuma dhe pjesa e shitjeve të bio karburanteve në përzierjet e diselit mbi 5 % në Kosovë do të monitorohet, Draft Udhëzuesi Administrativ siguron që një raport vjetor do të elaborohet.</p> <p>3. MEM-i, së bashku me MMPH, do të rishikojë udhëzimin administrativ mbi përdorimin e bio karburanteve, duke marr parasysh kost-efektivitetin, konkurrencën dhe sigurimin e furnizimit të bio karburanteve dhe karburanteve ripërtëritëse, dhe adopto, nëse e përshtatshme, masat promovuese për këtë efekt.</p>
	c	Siguro që informata është dhënë për publikun mbi disponueshmërinë e bio karburanteve dhe karburanteve tjera ripërtëritëse (Neni. 3.5):	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik 2008	Për përqindjen e bio karburanteve, përzierjet në derivatet e vajit mineral, që tejkalon limitin e vlerës së 5% të yndyrës së ester metil acidit (FAME) ose 5% të bio etanolit, etiketim specifik në pikën shitëse do të imponohet (Neni. 3.5);
			MEM-i, MTI dhe MTT	Qershor 2008	Draft udhëzuesi administrative mbi bio karburantet në transport përfshinë obligimet e pikave shitëse të etiketimit të bio karburanteve kompozuar më shumë se 5% të yndyrës së ester metil acidit ose bio etanolit. MTI do të publikojë listën me pikat shitëse në të cilat bio karburantet dhe karburantet tjera ripërtëritëse janë në disponueshmëri
2.	<b>Raportimi i kërkesave (Neni. 4)</b>				
	a	<p>Raporti mbi (Neni. 4.1):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Masat e marra për promovimin e bio karburanteve apo karburanteve tjera ripërtëritëse për zëvendësim të diselit ose për qëllime të transportit;</li> <li>▪ Resurset kombëtare të alokuar për prodhimin e bio masës për përdorim të energjisë, ose qëllimeve tjera se sa për transport; dhe</li> <li>▪ Totalin e shitjes së karburantit të transportit dhe</li> </ul>	Palët Kontraktuese	Jo më vonë se data 1 Korrik dhe pas kësaj çdo vit 2008	<p>Në raporte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Indiko nivelin e caqeve indikativë kombëtare sipas fazave;</li> <li>▪ Motivo diferencimin e caqeve kombëtare siç krahasohet me vlerat referuese të referuara në Nenin. 3.1.b.</li> </ul>

**Plani Kosovar për Implementimin e *Acquis* mbi burimet Ripërtëritëse (Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC)**

I	II		III	IV	V
Nr	VEPRIMI		AUTORITETET PËRGJEGJËSE	KOMPLETIMI I KORNIZËS	DOKUMENTET REFERUESE, KOMENTET DHE STATUSI I VEPRIMIT
		pjesës së bio karburanteve, të pastërta ose të përziera, dhe karburanteve tjera ripërtëritëse të plasuar në treg për vitin paraprak	MEM-i, MTI dhe MTT	Qershor 2008	Raporti do të përfshijë caqet indikative të definuar për secilin vit. Variacionet e caqeve krahasuar me vlerat referuese në Nenin. 3.1.b do të zbatohen.
	b	Raporti mbi progresin e bërë mbi përdorimin e bio karburanteve dhe karburanteve tjera ripërtëritëse të Palëve Kontraktuese (Art. 4.2)	Këshilli Evropian	Jo më vonë se data 1 Korrik 2010, dhe pas kësaj çdo 2 vite	Raporti do të mbulojë së paku gjërat të theksuar në Nenin 4.2;  Në bazë të raportit, kur e duhur, Këshilli do të dorëzojë propozimet në adoptimin e sistemit të caqeve (Neni. 4.2);  Nëse ky raport konkludon që caqet indikative nuk mund të arrihen për shkaqe jo të justifikuar dhe/ose nuk lidhet me evidenca të reja shkencore, këto propozime do të adresojnë caqet kombëtare, përfshirë mundësin e caqeve mandator, në formë të duhur;

**Shkurtesat**

MEM – Ministria e Energjisë dhe Minierave

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MTT – Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë

KOSTT – Transmisioni i Energjisë Elektrike dhe Operatori i Tregut

KEK JSC – Gjenerimi i Energjisë dhe Kompania e Aksioneve të Përbashkëta Publike të Distribucionit të Kosovës